

VENDIM
Nr. 67, datë 22.1.2020

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
FINANCIVE DHE EKONOMISË TË DISA PASURIVE DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHETETËRORE TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të pasurive “godinë 2-katëshe (zyrat)”, “godinë 3-katëshe (zyra, magazinë)”, “distributori, depozitë (furnizim)”, “6 garazhe 1-katëshe (parkime)”, “godinë 1-katëshe (oficina)”, “godinë 1-katëshe (rep. kol. lavazh)”, “godinë 1-katëshe (rep. gom. kovaçanë)”, “godinë 1-katëshe (magazinë)”, “godinë 1-katëshe (magazinë)”, “godinë 1-katëshe (repart)”, “truall i lirë (sheshi kryesor)”, “truall i lirë (shesh para ofic.)”, “truall i lirë (lulishte)”, “truall i lirë (shesh për garazhe)”, “truall i lirë (shesh për kalime)”, në zonën kadastrale 8220, Tiranë, sipas planrilevimit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Pasuritë me emërtimin “godinë 2-katëshe (zyrat)”, “godinë 3-katëshe (zyra, magazinë)”, “distributori, depozitë (furnizim)”, “6 garazhe 1-katëshe (parkime)”, “godinë 1-katëshe (oficina)”, “godinë 1-katëshe (rep. kol . lavazh)”, “godinë 1-katëshe (rep. gom. kovaçanë)”, “godinë 1-katëshe (magazinë)”, “godinë 1-katëshe (magazinë)”, “godinë 1-katëshe (repart)”, “truall i lirë (sheshi kryesor)”, “truall i lirë (shesh para ofic.)”, “truall i lirë (lulishte)”, “truall i lirë (shesh për garazhe)”, “truall i lirë (shesh për kalime)”, në zonën kadastrale 8220, Tiranë, hiqen nga lista e inventarit që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama